



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 302 / Prot. 3

Tiranë, më 5 / 4 / 2017

REKOMANDIM

Nr. 07, datë 5 / 4 / 2017

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 72-112 të Ligjit Nr.44/2015 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave në ngarkim të kontrolluesit "Globus Travel", Tiranë;

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit nr. 48, datë 15.02.2017, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit e Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit, "Globus Travel" (Nipt K31421021Q) me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit i Ligjit Nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij.

Kontrolluesi "Globus Travel" ka si objekt të veprimtarisë tregtare atë të ofrimit të shërbimit në fushën e turizmit dhe transportin ndërkombëtar të udhëtarëve. Gjatë ofrimit të shërbimeve përpunon të dhëna personale kryesisht për kategorinë e subjekteve të të dhënave "klientë", manualisht dhe në format elektronik. Të dhënat personale të klientëve që përpunohen janë: emër, mbiemër, numër telefoni, qyteti ku banon, numër pasaporte dhe adresë e-mail. Për kategorinë "punëmarrës", kontrolluesi përpunon të dhëna të identifikimit, nëpërmjet administrimit të dokumenteve në dosjen e punës për qëllime të menaxhimit të burimeve njerëzore. Kontrolluesi, përpunon të dhëna personale për kategorinë klientë përmes portalit [portal.cosmos.al](http://portal.cosmos.al) që ka në administrim.

1. Zyra e Komisionerit konstatoi se kontrolluesi "Globus Travel" gjatë ushtrimit të aktivitetit nuk i informon subjektet e të dhënave personale (klientët), mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, nenet 12, 13, 15, 16 dhe 17 të ligjit, afatin e mbajtjes së të dhënave, dhe masat e sigurisë, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Nga verifikimi i kryer në faqen online të kontrolluesit [globustravel.al](http://globustravel.al) nuk është i parashikuar informimi nëpërmjet rubrikës "politikat e privatësisë". Në faqen e kontrolluesit përmes formës së kontaktit për marrjen e ofertave, mblidhen të dhënat personale, emër, mbiemër, email, nr. telefoni; Çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes online në internet, ka detyrimin që të publikojë "Politikat e



privatësisë”, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash realizohet nëpërmjet faqes online në internet. Në këtë kuadër, publikimi i “Politikave të privatësisë” përmbush më së miri qëllimin që ka neni 18 i ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit vlerëson se mospublikimi i “politikave të privatësisë” në faqen e internetit, privon subjektet e të dhënave personale nga e drejta për informim (në bazë të nenit 18) dhe të drejtat e parashikuara në kreun IV “Të drejtat e subjektit të të dhënave”, të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, duke mos u dhënë mundësi në ushtrimin e tyre dhe duke i cënuar ato.

2. Kontrolluesi “Globus Travel”, ka vendosur në ambientet e brendshme kamra vëzhgim-regjistrimi CCTV, nëpërmjet sistemit të video-survejitimit mbledh dhe përpunon të dhënat personale imazhe dhe video të subjekteve të të dhënave klientë dhe punëmarrës. Në lidhje me këtë përpunim u konstatua se kontrolluesi nuk realizon informimin e subjekteve të të dhënave nëpërmjet tabelave informuese mbi prezencën e sistemit të kamerave të survejitimit në hyrje të ambienteve ku ushtron veprimtarinë e tij, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit Nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar dhe me Udhëzimin e Komisionerit nr. 3, datë 05/03/2010 “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejitimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar.

3. Në kuadër të zbatimit të detyrimit për njoftim, nenet 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, u konstatua se kontrolluesi “Globus Travel”, ka përmbushur detyrimin për njoftim në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar. Nga analizimi i formularit të njoftimit rezultoi se ka mangësi (nuk është përditësuar ndryshimi i gjendjes së njoftimit) në disa rubrika, konkretisht: 1.1 (numër telefoni dhe faksi), 3.1 (kategoria punonjësi dhe të tjerë të mundshëm), 4.1 (nuk janë specifikuar të gjitha kategoritë e të dhënave të tilla si numër telefoni, adresë e-maili dhe të dhënat që mblidhen nëpërmjet sistemit CCTV), 6.1 (nuk është specifikuar qëllimi i përpunimit në përputhje me kategoritë e të dhënave si psh: marketingu dhe siguria e ambienteve) 7.1 (ka përhapje të dhënash në institucione publike në kuadër të zbatimit të ligjit).

Zyra e Komisionerit vlerëson se detyrimi për njoftim dhe përditësimi i “Formularit të Njoftimit” është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep ligji.

4. Kontrolluesi ka miratuar “Rregulloren për përpunimin e të dhënave personale të punonjësve dhe klientëve” por nga analizimi i saj rezultoi që nuk janë parashikuar rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave nëpërmjet sistemit CCTV, të drejtat e subjekteve etj, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar;

Hartimi i rregullores është i rëndësishëm për kontrolluesin pasi përbën bazën e referimit për çdo përpunim të të dhënave, për çdo punonjës, dhe përcakton standartet ligjore për garantimin e një përpunimi të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave personale. Rregullorja duhet të jetë gjithëpërfshirëse (të përfshijë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale për çdo kategori subjektësh të të dhënave).



Për shkeljet e konstatuara është mbajtur procesverbali i konstatimit, si dhe në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", në datën 21/03/2017 është mbajtur seanca dëgjimore me përfaqësuesin e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar. Kontrolluesi gjatë seancës dëgjimore ka depozituar disa dokumente dhe prova në kuadër të realizimit të problematikave dhe shkeljeve të konstatuara në procesverbalin e hetimit administrativ, si më poshtë:

- ✓ Pamje nga vendosja e tabelave informuese për sistemin CCTV;
- ✓ Politika e Privatësisë (e vendosur në faqen online);

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 18, 21, 22, 27, 29, 30, 31 dhe 32 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

### REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi "Globus Travel", në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar:
  - Të marrë masa për të përfshirë në faqen e tij të Internetit në rubrikën "Politikat e Privatësisë" informacionin sipas Opinionit të Komisionerit "Mbi mbrojtjen e të dhënave personale në faqet e internetit të kontrolluesve publik dhe privat";
  - Të marrë masa për vendosjen e tabelave informuese për sistemin e video-vëzhgimit, sipas modelit standard të tabelës informuese të përcaktuar në Udhëzimin e Komisionerit nr. 3, datë 05/03/2010 "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", i ndryshuar.
2. Kontrolluesi "Globus Travel", në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e formularit të njoftimit, për të gjitha ndryshimet e mundshme në përpunimin e të dhënave personale në vazhdimësinë e aktivitetit të tij.
3. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të respektohen në vazhdimësi masat teknike dhe organizative të sanksionuara në "Rregulloren e brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale", të miratuar nga kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave të klientëve, si dhe të përfshihen në këtë rregullore, rregulla të posaçme për përpunimin e të dhënave përmes sistemit të kamerave CCTV.
4. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimit të parashikuar në këtë Rekomandim, brenda një afati 30 ditor nga momenti i marrjes dijeni dhe të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Plotësimi i këtyre detyrimeve ligjore mund të jetë objekt kontrolli në vazhdimësi nga Zyra e Komisionerit.

5. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky rekomandim u shpall sot më datë 5, 9 2017.

**Besnik DERVISHI**  
  
**KOMISIONERI**

